

VASIL KRISTO

**BOTIMET GJEOGRAFIKE DHE ARSIMIMI
GJEOGRAFIK NË PERIUDHËN 1912-1939**

Në këtë artikull kemi paraqitur çfarë tekstesh gjeografike janë botuar gjatë periudhës 1912-1939, cilat ishin njohuritë që jepeshin, cili ishte niveli shkencor e metodik i tyre, çfarë vendi zinte gjeografia e vendit tonë dhe çfarë roli kanë luajtur botimet gjeografike të kësaj periudhe në arsimimin gjeografik dhe edukimin e nxënësve.

*

*

*

Gjeografia si lëndë mësimore gjatë periudhës 1912-1939 zhvillohej që në klasën e tretë të shkollës fillore. Në këtë klasë nxënësit merrnin disa njohuri nga fusha e gjeografisë së përgjithshme, në të katërtën nga gjeografia e Shqipërisë dhe në të pestën nga gjeografia e shteteve. Në klasën e parë të shkollës së mesme zhvillohej gjeografia e përgjithshme, në klasën e dytë zhvillohej gjeografia e Shqipërisë dhe në vitet më të larta, gjeografia regjionale.

Për mësimin e gjeografisë në shkollë, në vitet e para pas shpalljes së Pavarësisë së vendit deri në vitin 1920, janë shfrytëzuar tekstet “Dheshkroje për Msojtore” dhe “Shcypnia” botuar që të dy më 1902, “Dheshkronja” e Mit’hat Frashërit botuar më 1909 dhe “Dheshkroje për Msojtore Popullore e Gjytetnore” e Gaspër Mikelit botuar në vitin 1912 në prag të Shpalljes së Pavarësisë. Mund të jenë përdorur dhe “Dheshkroja” e S. Frashërit e “Dituritë” e N. Frashërit. Me forcimin e shtetit shqiptar, pas vitit 1920, u botuan dhe tekstet e parë të gjeografisë pas Shpalljes së Pavarësisë.

Nga viti 1920 deri në vitin 1939 u botuan 10 tekste për ciklin e ulët dhe katër tekste për shkollën e mesme. Me botimin e këtyre teksteve, njohuritë gjeografike, që merrnin nxënësit, shtoheshin vazhdimisht dhe rritej niveli shkencor i saj. Çfarë përmbanin këto tekste dhe cili ishte niveli shkencor e metodik i tyre do të njihemi në vazhdim. Po fillojmë të

përmendim disa nga çështjet më kryesore, që mësonin nxënësit nga fusha e gjeografisë së përgjithshme.

Teksti i parë i botuar pas Shpalljes së Pavarësisë së vendit është teksti me titull “Gjeografi”, për shkollat fillore me autor Dhori Koti, botuar më 1920. Nga përmbajtja ky tekst përfaqëson një tekst të gjeografisë të përgjithshme. Si të gjithë tekstet shkollore ky tekst fillon me objektin e gjeografisë. *Sipas Dh. Kotit fjala gjeografi do të thotë Dheshkronjë, d. m. th. përshkrimi i Dheut (Tokës V. K.), që si është, ç’ka, ç’përmban dhe ç’gjëndet për mi të.*¹ Teksti përbëhet nga tre pjesë:

Në pjesën e parë trajtohen elementët astronomikë e fizikë të Tokës (trajtohen forma sferike e Tokës, polet, hemisferat, etj.), ndarja e saj në kontinente dhe në oqeane si dhe konceptet më të përgjithshme fiziko-gjeografike siç quhet kontinent (këtu përmenden edhe emrat e pesë kontinenteve), fushë, mal, varg malore, gjelbërORE (oaz), oqean, det, mëngë, liqen, burim, baticë e zbaticë, ishull, gadishull, pellgore (arkipelag), etj. *P. sh. në tekst shkruhet: “Varg quhet një radhë prej malesh ose kodrash”*² ... dhe në vazhdim shkruhet: “mëngë quhet një pjesë e gjirit më e futurë në tokë”³. Për të gjitha këto jepen gjithashtu dhe veçoritë e tyre. Këto njohuri e koncepte kanë qenë të mjaftueshme e të kapshme nga nxënësit, dhe janë shprehur me saktësi shkencore.

Në pjesën e dytë trajtohen racat njerëzore, fetë në botë, mënyrat e qeverisjes dhe qytetërimi. Këto dukuri sot janë objekt i studimit të gjeografisë ekonomike të përgjithshme. Në tekst sipas mendimit të kohës jepen tre racat kryesore (e bardhë, e zezë dhe e verdhë) si dhe raca e kuqe (që banon në Amerikë). Në besimet fetare përmenden feja e krishterë (ortodoksët, katolikët dhe protestanët), muhamedane dhe judaiste, që janë fe monoteiste, dhe feja brahmane (Hindu - V. K.) e budiste, që janë politeiste. Jepet dhe numri i besimtarëve për secilën fe. Mandej vazhdohet me qeverisjen e shteteve dhe me qytetërimin. Në qeverisjen e shteteve përmenden mbretëritë dhe republikat. *Me qytetërim Dh. Koti quan shkallën e diturisë së njerëzve.* Sipas qytetërimit dallohen “të egërit”, që janë njerëzit primitivë, “të arratisurit”, që janë nomadët dhe “të qytetëruarit”, që janë njerëzit, që jetojnë e ndërtojnë fshatra, qytete, punojnë tokën, ndërtojnë fabrika, kanë shkolla, spitale, etj. Po në

¹ Dhori Koti, *Gjeografi për shkollat fillore*, Korçë: 1920, f. 3.

² *Po aty*, f. 6.

³ *Po aty*, f. 8.

këtë pjesë bëhet fjalë edhe për klimën dhe resurset (pasuritë) që jep Toka. Me fjalë të thjeshta jepet nocioni ç'quhet klimë (në tekst shkruhet: "*klimë quhet gjendja e ngrohtësirës, të ftohtësirës, të lagështirës, të thatësirës dhe të erës që ndodhet në një vend*"⁴), jepen shkaqet e ndryshimit të klimës si dhe rolin që luan njeriu në klimë.

Me pasuri sipas autorit quhen të gjitha gjërat, që pjell, përmban ose ushqen toka (dherat). Pasuritë i klasifikon në tre llojesh: metalet (mineralet - V. K.), bimët dhe kafshët. Trajtohen ç'janë metalet, bimët e kafshët, kush bën pjesë në to dhe si i përpunon njeriu.

Në pjesën e tretë bëhet fjalë për gjeografinë regjionale dhe gjeografinë e Shqipërisë. Mbas tekstit të Dh. Kotit botohen në Shkodër më 1926 tre libra të titulluar me të njëjtin emër "*Njoftime gjeografijet për klasët fillore*" I, II dhe III.

Në tekstin "*Njoftime gjeografijet*" I, për klasën e tretë, përmbajtja e tij në pjesën më të madhe është e ndryshme nga ajo e gjeografisë së Dh. Kotit. Tekstin mund ta ndajmë gjithashtu në tre pjesë:

Në pjesën e parë jepen disa njohuri si ç'është horizonti, ç'janë pikat bazë të horizontit, ç'kuptojmë me orientim në terren dhe si mund të orientohemi nëpërmjet yllit polar, me busull, etj. (Në tekst shkruhet: "*horizonti është ajo vijë e largët, në të cilën i duket syrit tonë, se qielli përpiqet (takohet - V. K.) me detin ose tokën . . . orientim do të thotë të gjeturit e drejtimit*"⁵). Mandej jepen njohuri për trëndafilin e erërave e drejtimin e erërave, duke i lidhur ato me pikat e horizontit, si dhe për planin, hartat topografike e hartat gjeografike. Duke bërë fjalë për hartat gjeografike, tregohet gjithashtu dhe ç'është gjeografia (në tekst shkruhet: "*Gjeografia përshkruen një trevë të Tokës o të gjithë sipërfaqen tokësore*"⁶).

Në fillim të pjesës së dytë jepen konceptet për objektet fiziko-gjeografike si ç'quhet kodër, mal, vargmalor, vullkan, burim, rrjedhë ujnash (ujëra rrjedhëse - V.K.), etj. Gjithashtu tregohet ç'janë oqeanet dhe kontinentet (jepen dhe emrat e tyre), ç'janë liqenet, ishujt, gadishujt, gjiret, kepet, etj. *Kështu në tekst shkruhet: "Vëndi kah buron një rrjedhë thohet gurrë (burim - V. K.). "... Oqeane thohen detnat ma të mdhaj e janë katër . . . Sterat (kontinentet - V. K) janë katër copat ma të mdhat e*

⁴ Po aty, f. 11.

⁵ *Njoftime Gjeografijet*, I, Shkodër: 1926, f. 3-4.

⁶ Po aty, f. 8.

tokës qi janë të rrethueme krejt prej oqeaneve⁷". Mandej përshkruhet Toka si planet (trajtohet forma sferike, lëvizjet e saj, si formohet dita dhe stinët, etj.), polet, paralelet, meridianët, hemisferat, brezat e ngrohtësisë, etj. *Për këto në tekst shkruhet: "Toka ka trajtën e një sferës ... Toka lëviz në hapsirë në dy mënyra njëherësh: njëra rreth vetes e tjetra rreth Diellit. ⁸" ... kurse për brezat e ngrohtësisë shkruhet: "dallohen brezi akulluer(ftohtë V. K.) verior e jugor, brezi i përkuerm (mesatar - V. K.) verior e jugor dhe brezi i vapulluem (nxehhtëV. K)⁹"* . Për të gjitha këto, jepen dhe veçoritë e tyre.

Në pjesën e tretë trajtohen disa çështje të popullsisë në botë. Në këtë pjesë nxënësit marrin njohuri për popullsinë absolute (numrin e saj), për dendësinë e popullsisë, racat njerëzore ku përmenden tre raca kryesore (e bardhë, verdhë dhe e zezë) dhe numri i popullsisë për çdo racë. Përmenden edhe raca të tjera si ajo e kuqe, raca zeshkane, raca të veçanta. Këto dukuri sot janë objekt i studimit të gjeografisë ekonomike të përgjithshme.

Në tekstin "Njoftime gjeografijet" II, pjesa e parë i kushtohet gjeografisë së Shqipërisë, kurse në pjesën e dytë jepen njohuri nga fusha e gjeografisë fizike, ku trajtohen atmosfera, hidrosfera dhe konfiguracioni i Tokës.

Duke trajtuar atmosferën nxënësit merrnin njohuri për elementët meteorologjikë të saj (temperaturën, lagështirën, shiun, borën, breshërin, erën, etj.) dhe për klimën e tipet e saj (klimën detare e kontinentale), etj., duke shpjeguar dhe si ato formohen. *Kështu në tekst shkruhet: ... "Kto lëvizje të ajrit të përfitueme prej ndryshimit të qetësisë (nxehhtësisë - V.K.) thohen erna¹⁰"*. Në hidrosferë trajtohen ujërat detare (temperatura, kripësia, valët detare, baticat e zbaticat dhe rrymat oqeanike), dhe ujërat kontinentalë (burimet, lumenjtë, përrenjtë e ndryshimi i nivelit të ujit në ta, liqenet e kënetat). Për të gjitha këto jepen veçoritë dhe shpjegimet përkatëse. *Kështu në tekst shkruhet: "Uji i detit asht i njelmë (kripur - V.K.), prandaj nuk pihet e asht ma i randë se uji i lumnave pse ka krypë ... Ujnat e detit të tunduna prej erët (erës - V.K.) bajnë tallazet (valët - V.K.)¹¹"*. Po kështu veprohet dhe për ujërat kontinentalë.

⁷ *Njoftime Gjeografijet ...*, I, f. 18-19.

⁸ *Po aty*, f. 21.

⁹ *Po aty*, f. 22.

¹⁰ *Njoftime Gjeografijet*, II, Shkodër: 1926, f. 23-24.

¹¹ *Po aty*, f. 25.

Gjatë trajtimit të konfiguracionit të Tokës, përshkruhet konfiguracioni horizontal e vertikal i oqeaneve e kontinenteve dhe i pjesëve përbërëse të tyre (i deteve, gjireve, ngushticave, brigjeve detare, etj., gadishujve, ishujve, maleve, vargjeve malorë, kodrave, rrafshnaltave, luginave, etj.). Po këtu bëhet fjalë dhe për vullkanet, tërmetet e akullnajat. Për të gjitha këto jepen tiparet e tyre dhe si ato formohen.

Në dallim nga “Njoftime Gjeografijet” I dhe II, në tekstin “Njoftime Gjeografijet” III, bëhet fjalë vetëm për gjeografinë e kontinenteve.

Në ndihmë të shkollës fillore kanë shërbyer dhe tekstet e Ismail Anamalit, të titulluar “Atdheu dhe Bota” për klasën e 3-të dhe “Atdheu e Bota” për klasën e 4-të, botuar më 1929. Në tekstin e parë jepen njohuri nga fusha e gjeografisë së përgjithshme, kurse në të dytin bëhet fjalë për gjeografinë e Shqipërisë dhe atë botërore (regjionale). Sipas përmbajtjes, tekstin “Atdheu e Bota” për klasën e 3-të, mund ta ndajmë në tre pjesë:

Në pjesën e parë jepen njohuri për Tokën si planet dhe trupat e tjerë qiellorë (Yjet, Diellin dhe Hënën). *Për ta shkruhet: “Hyjt, qi shohim në qiell janë të ndritshëm si Dielli. Këta duken në qiell si pika a xhixha të ndritëshme, mbasi gjinden shumë larg prej Dheut tonë(më larg edhe se Dielli).¹²”*... Më gjerë flitet për Diellin duke përshkruar tiparet e tij (madhësinë, dritën e nxehtësinë) dhe rolin që ai luan në zhvillimin e jetës në Tokë. Midis të tjerave shkruhet: . . . *“Edhe Dielli, qi na ngrohë e na gëzon, asht një hyll i madh, qi nxjerrë zjarm ... Ngrohtësia e Diellit shkakton gjallmin (gjallërinë - V.K.) e ç’do sendi të Tokës. Dielli rrit bimët e gjethet dhe neve na ep gjak e jetë¹³”* ... Po kështu përshkruhet Hëna. Në vazhdim bëhet fjalë për horizontin, pikat e horizontit dhe orientimin me anën e busullës, Diellit dhe Yllit Polar. Po këtu përshkruhet ç’është plani, përse përdoret dhe si ndërtohet. Tregohet ç’janë hartat, çfarë përmbajnë dhe përse përdoren.

Në fillim të pjesës së dytë analizohen e shpjegohen konceptet fiziko-gjeografike., si p. sh. ç’quhet bregdet, liman, gji detar, ishull, gadishull, mal, majë mali, kodra, vargje malorë, fusha, rrafshnalta, etj. Gjithashtu bëhet përshkrimi morfografik e morfometrik dhe jepen edhe tiparet e tyre. *Kështu p, sh. për vargjet malorë shkruhet : “ kur malet janë të puqun njeni me tjetrin dhe ndjekin shoqi shoqnë, marrin emërin vargje malesh. Bjeshkët e Shqipnis së Sipërme janë vargje malesh me randësi¹⁴ ... , kurse*

¹² Ismail Anamali, *Atdheu e Bota për klasën e tretë fillore*, Shkodër: 1929, f. 9.

¹³ *Po aty*, f. 11.

¹⁴ *Po aty*, f. 18.

për fushat shkruhet: vëndet qi janë të sheshët, e qi nuk janë të ngritun si malet e kodrat, quhen fusha. ... Fushat kanë tokë të pleshshme (pjellore V. K.)¹⁵” ... Kjo pjesë mbaron me trajtimin e disa dukurive fiziko-gjeografike si ç’është shiu e si formohet, ç’janë përrrenjtë e lumenjtë e si ata formohen, cilët janë pjesët përbërëse të tyre, si ndryshon niveli i ujit në ta gjatë stinëve të vitit, etj. Flitet gjithashtu dhe për shfrytëzimin e energjisë së lumenjve për të fituar energji elektrike, për të ujitur, për lundrim, etj. Këtu trajtohen edhe lumenjtë më të mëdhenj të Shqipërisë.

Në pjesën e tretë trajtohen dukuri që i takojnë fushës së gjeografisë ekonomike, të tilla si çfarë përfaqëson bujqësia, tregtia e industria, ç’është qeveria, kombi, etj. *Kështu në tekst shkruhet: “Qeveri e Shtet quhet fuqija qi siguron bashkimin e njerëzve qi jetojnë së bashku e qi janë prej një kombi¹⁶”.*

Në numrin e teksteve gjeografike për shkollat fillore një vend të rëndësishëm zë dhe teksti i Perikli Ikonomit “Atdheshkronja e Plotë”, për kl. 3 dhe të 4-të të shkollave fillore, botuar më 1932.

Në renditjen e çështjeve që trajtohen ka një ndryshim me tekstet e tjerë të përmendur më lart. Sipas çështjeve që trajtohen, teksti përbëhet nga disa pjesë:

Në fillim të pjesës së parë nxënësit mësonin për planin, shkallën e zvogëlimit, pikat kryesore të horizontit, dhe mënyrat e orientimit. Po këtu trajtohet dhe era (drejtimi, forca dhe shpejtësia) dhe roli i saj. *Kështu në tekst shkruhet: “Era shkaktohet nga ajri, që lëviz fort nga një anë e horizontit në tjetrën. ... Era, kur fryn rreptë shkakton valë në det. ... shkull bimë të mëdha. ... edhe na atëhere e quajmë stuhi. ... Kah një herë stuhin e pason edhe shi me rrëmbim¹⁷”.* ... Në vazhdim në tekst bëhet fjalë për fshatin dhe qytetin dhe dallimet ndërmjet tyre, llojet e ndërtimeve në ta e përse ato shërbejnë, etj. *Kështu midis të tjerash shkruhet: “Qyteti ka shtëpi të mëdha, ... shumë lagje, ... rrugë të gjana e të drejta, ... shkolla të nalta dhe t’ulta, gjykatore, spitale, post-telegrafë, etj. ¹⁸”.* ... Po në këtë pjesë jepen disa njohuri për bimësinë (si ç’janë, kopshtet, arat, vreshtat, ullishtet, livadhet e pyjet, çfarë bimësh e drurësh rriten në to, dhe cila

¹⁵ *Po aty*, f. 20.

¹⁶ *Po aty*, f. 32.

¹⁷ Perikli Ikonomi, “Atdheshkronja e Plotë” për klasën e tretë e të katërt të shkollës fillore, Korçë: 1932, f. 15.

¹⁸ *Po aty*, f. 22-23.

është rëndësia e tyre) dhe botën shtazore (si ç'janë kafshët e buta e të egra, kush bën pjesë në to, cila është rëndësia e tyre, etj.).

Në fund të kësaj pjese flitet për mineralet (ç'janë mineralet, përse përdoren dhe cila është rëndësia e tyre), për mjeshtëritë (artizanatin e industrinë) dhe rëndësinë që kanë ato(mjeshtëritë) në përpunimin e mineraleve dhe lëndëve bujqësore e blegtorale. *Për të gjitha këto në tekst shkruhet: "kafshët, bimët e mineralet quhen prodhime natyrore. ... Buka, gjalpi, djathi, këpucët, veshjet e të tjera të tilla quhen prodhime mjeshtërore. ... Prodhimet mjeshtërore janë industria e një vëndi¹⁹". ...*

Në fillim të pjesës së dytë jepen konceptet fiziko-gjeografike. Edhe këtu si në tekstet e mësipërme trajtohet sipërfaqja e Tokës (malet, fushat, etj.), jepen veçoritë e tyre si pamja, lartësia, shpatet, luginat, grykat, e të tjera forma në male, bimësia që rritet në ta, kulturat bujqësore që mbillen në rrëzë të tyre, etj. Duke trajtuar malet, bëhet fjalë gjithashtu për vullkanet, magmën, etj. Në vazhdim bëhet fjalë për ujërat, ku trajtohen me radhë burimet, përrenjtë e lumenjtë, liqenet e kënetat, si është uji në ta, si janë formuar dhe cili është roli i tyre, trajtohen detet(ç'quhet det, si është uji në det, ç'janë valët detare e nga kush formohen), përse përdoret uji i detit e rëndësinë që kanë detet për lundrim, etj. Po këtu jepen konceptet ç'quhet gji detar, kep, ishull, gadishull, etj. Mënyra e trajtimit dhe e interpretimit të këtyre objekteve dhe dukurive të përmendura në këtë pjesë është e njëjtë si edhe në tekstin e Dh. Kotit, I. Anamalit, dhe "Njoftime gjeografijet". Në pjesën e tretë bëhet fjalë për gjeografinë e Shqipërisë e të shteteve fqinj.

Në pjesën e katërt ose të fundit trajtohet Toka si planet, pra jepen të dhëna për bazat astronomike të gjeografisë. Si edhe në tekstet e mësipërme, këtu nxënësit marrin njohuri për formën sferike të Tokës, polet, boshtin e Tokës, ekuatorin, lëvizjet e Tokës e pasojat e tyre, etj. Mandej jepen të dhëna për kupën qiellore dhe trupat qiellorë (për yjet, Diellin, Hënë, etj.). Edhe në këtë tekst më gjerë flitet për Diellin dhe Hënë. Theksohet se Dielli është ylli më i afërt dhe jepen të dhëna për formën e tij, nxehtësinë që ai zotëron, eklipsin diellor, rolin që ai luan, etj. Po në këtë pjesë bëhet fjalë për mjegullën, retë, shiun, breshërin, e borën, pra jepen disa tipare të motit.

Edhe në shkollat e mesme mësimi i gjeografisë zinte një vend të rëndësishëm. Në tekstet për shkollat e mesme të kësaj periudhe, njohuritë

¹⁹ Po aty, f. 30.

gjeografike të dhëna janë të shumta, dhe më të plota, nga të gjitha fushat e gjeografisë, trajtohen gjithë gama e dukurive gjeografike natyrore, ekonomike, politike, shoqërore, si dhe ajo botërore.

Për një kohë të gjatë në shkollat e mesme është përdorur teksti “Dheshkroje për Msojtore Popullore e Gjytetnore” i G. Mikelit*, botuar më 1912 e ribotuar më 1916. Për nga përmbajtja, sasia e të dhënave gjeografike dhe niveli shkencor ai ishte një tekst i rangut europian i përshatshëm për shkollat e mesme. Teksti përbëhet nga tre pjesë:

Në pjesën e parë jepen bazat astronomike të gjeografisë. Në të trajtohen në mënyrë të hollësishme dhe në tërë gamën e tyre trupat qiellorë(yjet, Dielli, Hëna, Toka, planetët, etj.) Po këtu bëhet fjalë për meridianët, paralelet, gjerësinë e gjatësinë gjeografike, për baticat e zbaticat, etj. I gjithë materiali shoqërohet me analizat e shpjegimet përkatëse dhe sipas të dhënave shkencore.

Në pjesën e dytë trajtohen gjerësisht dhe në të gjitha aspektet e tyre gjeosferat e Tokës(atmosfera, hidrosfera, litosfera) dhe dukuritë që ndodhin në to. Pra në tërësi trajtohet gati e gjithë gama e dukurive fiziko-gjeografike, që përfshihen në lëndën e gjeografisë fizike të përgjithshme.

Në pjesën e tretë trajtohen dukuri, që i takojnë gjeografisë ekonomike të përgjithshme (trajtohen probleme të përgjithshme të popullsisë, racat njerëzore, besimet fetare, gjuhët, rendi shtetëror, etj.).

Një vend të rëndësishëm në mësimin e gjeografisë në shkollat e mesme zë dhe teksti me titull “Gjeografi për shkollat e mesme pj. I” e Ndue Palucës, botuar më 1927. Si tekst shkollor ai fillon me objektin e gjeografisë dhe degët që e përbëjnë atë. *Në të shkruhet: “gjeografi quhet ai mësim, qi përshkruen ç’do gja, qi gjindet, qindron e jeton mbi fytyrë të Tokës²⁰”*. Sipas qëllimit që ka, gjeografia ndahet në tre pjesë (degë-V.K). Në pjesën e parë mësohen veçoritë e Tokës si trup qiellor, në pjesën e dytë përshkruhen gjërat dhe dukuritë në sipërfaqen e Tokës dhe visaret e mineraleve, bimët dhe kafshët, në pjesën e tretë shfaqet Toka si vend banimi e njerëzve, d. m. th. tregohet ndikimi i natyrës së Tokës mbi jetesën e banorëve dhe veprimi i njerëzve mbi natyrën. Në tekstin në fjalë përshkruhen vetëm dukuri që i takojnë pjesës (degës) së parë dhe të dytë. Po flasim shkurtimisht për to:

* Me hollësi për përmbajtjen dhe vlerat e tekstit të G. Mikelit shih artikullin e V. Kristos “Rreth arsimimit gjeografik në shkollat shqipe në periudhën 1887-1912”, në *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2011.

²⁰ Ndue Paluca, *Gjeografia për shkollat e mesme*, Tiranë: 1927, f. 3.

Në pjesën e parë jepen njohuri për qiellin duke e përcaktuar atë si një hapësirë pa kufi, në të cilin qëndrojnë pezull të gjithë trupat qiellorë. Mandej analizohen e përshkruhen trupat qiellorë, ku më gjerësisht trajtohet Toka si planet e Dielli. . *Kështu për ta shkruhet: “Hyjt janë trupa qiellorë të shndritshëm. ... Ata shndrisin me dritë të vet dhe kanë ngrohtësinë e vet. ... planetët janë trupa qiellorë t’errët qi marrin dritë e ngrohtësi prej Diellit. ... Trupi i Diellit asht në gjëndje gasore të zjarrët. ... Dielli asht burimi i dritës, i ngrohtësisë dhe i jetës mbi Tokë²¹”*. Njëkohësisht me to, jepen njohuri dhe për horizontin e mënyrat e orientimit, për hartat gjeografike (për përmbajtjen, shkallët, etj.), profilet topografike, globin, paralelet, meridianët, gjerësinë e gjatësinë gjeografike, etj. *Kështu midis të tjerave shkruhet: ... “ rrathët qi tërhiqen pingul ndaj ekuatorit dhe qi përshkohen nëpër të dy polat (të veriut dhe të jugut), quhen meridia apo rrathë gjatësie²²”*. ...

Në pjesën e dytë trajtohen gjeosferat përbërëse të Tokës (atmosfera, hidrosfera, biosfera, relievi, ndërtimi gjeologjik). Këto sot janë objekt i studimit të gjeografisë fizike të përgjithshme. Ato trajtohen gati në të gjithë aspektet. Kështu në atmosferë trajtohen elementet meteorologjike (temperatura e si ndryshon ajo në drejtim vertikal e horizontal, cilat janë mënyrat e llogaritjes së saj, si ndodh avullimi, ç’janë reshjet atmosferike e si bëhet matja e tyre, ç’është trysnia atmosferike e si ndryshon në drejtim horizontal e vertikal, ç’quhet erë, si ndodh lëvizja e ajrit, etj.). Për të gjithë këta elemente jepen shkaqet e faktorët që ndikojnë dhe si ata formohen. *Kështu në tekst shkruhet: “Ajri i lëvizun quhet erë. ... Dielli nuk i ngrohë të gjitha pjesët e tokës me masë të njinjishme, një pjesë merr ma shumë, një tjetër ma pak ngrohsi; prej ndryshimeve të ngrohsis të përfitueme kësodore (në këtë mënyrë - V. K.), shkaktohen erna²³”*. ...

Në hidrosferën në fillim përshkruhen veçoritë morfologjike të lumenjve e përrenjve (burimi i lumit, grykëderdhja, sistemi lumor, pellgu ujëmbledhës, etj., dhe si ato formohen, etj.) dhe hidrologjike (sasia e nivelet e ujit, shpejtësia, etj.). *Kështu në tekst shkruhet: “Të gjitha ujnat, qi bashkohen në një lum kryesuer (pra lumi kryesuer bashkë me lumnat ushqyes) sajojnë një systemë (sistem - V.K.) lumnash. sa ma i madh të jetë të mënjanuemit (pjerrësia - V.K.), aq ma me shpejtësi rrjedhë ujtë mbi*

²¹ *Po aty*, pj. I, f. 4.

²² *Po aty*, f. 21.

²³ *Po aty*, f. 24-25

shtrojen (shtratin - V.K.) e *vet*²⁴”. ... Po te lumenjtë trajtohet veprimtaria morfologjike dhe roli i tyre në ndryshimin e relievit të sipërfaqes së Tokës dhe rëndësia që ata kanë në jetën ekonomike të njeriut. Mandej vazhdohet me liqenet duke shpjeguar kur ata formohen dhe si formohen. Gjithashtu bëhet dhe klasifikimi i tyre në liqene me rrjedhje dhe në liqene jo me rrjedhje, sipas origjinës, sipas kripësisë, etj. Mbas ujërave kontinentalë trajtohen detet. Në fillim jepen konceptet ç’quhet det, gji detar, ngushticë, breg i detit (*në tekst shkruhet: “kufinin ndërmjet t’ujit të detit e të tokës e përban bregu (buza), qi si bregu i lumit mund të jetë i cekët apo i naltë (rrëpinët). ... Nji pjesë deti, qi futet mbrënda dheut, quhet gji*²⁵”), ç’quhet det i thellë e det i cekët, si dhe përshkruhen pjesët përbërëse të relievit të fundit të detit, etj. Megjithëse nuk emërtohen, në fakt bëhet fjalë për shelfin detar deri në 200m thellësi, shpatin kontinental nga 200-2500 m thellësi, fundin e detit me thellësi më të madhe se 2500m dhe humnerat ose abisalet.

Në vazhdim analizohen veçoritë e ujit të detit (kripësia e temperatura, valët detare, rrymat detare dhe baticat e zbaticat. *Në tekst shkruhet: ... “Këta të ngritun e t’ulun të rregullshëm të sypërfaqes s’ujit quhet batica dhe skurrima (zbatica - V.K.). Koha (gjasht orë), në të cilën deti hypën quhet baticë, koha e të zbrapsnit (gjithnji gjasht’ orë) quhet skurrimë (zbaticë)*²⁶”. ... Gjatë përshkrimit të këtyre, analizohen shkaqet e faktorët që ndikojnë, si ato formohen, dhe rëndësia që kanë, etj.

Duke trajtuar relievin e sipërfaqes së Tokës, bëhet përshkrimi morfografik e morfometrik i formave kryesore të relievit (maleve, kodrave, ultësirave, rrafshnaltave, etj.) si dhe i elementeve të tyre (të tillë si majat, kreshtat, shpatet, qafat, etj.). *Kështu për to shkruhet: “Ultësira quhen krahinat (sido qofshin të rrafshhta apo jo të rrafshhta) deri në 200m lartësi. ... Rrafshirë (ose fushë) quhet ajo pjesë e sipërfaqes së Tokës pak a shumë e gjanë, qi s’ka ndryshime të mdhaja naltsie dhe qi mund të mbikëqyret (ta përlejë syni) gjithkahë. ... Kur arrijnë mbi 1500m mbi nivelin e detit quhen rrafshnalta*²⁷”. E njëjta gjë bëhet dhe për malet ose bjeshkët. Po këtu trajtohen edhe luginat lumore duke i klasifikuar ato sipas tipeve (në lugina gjatësore e tërthore) dhe sipas pamjes së profilit

²⁴ *Po aty*, f. 32.

²⁵ *Po aty*, f. 34.

²⁶ *Po aty*, f. 35.

²⁷ *Po aty*, f. 37.

tërthor (në kanione, në lugina në formën e shkronjës V, shkronjës U, etj.) etj.

Gjatë trajtimit të relievit të sipërfaqes së Tokës, bëhet fjalë edhe për ndërtimin gjeologjik të saj, kryesisht për shkëmbinjtë, duke i klasifikuar ata në të fortë (gurtë), ku përfshihen granitet, gëlqerorët, ranorët dhe reshpet. dhe të shkrifët ku përfshihen zalli, zhuri, rërat, deltinat, humusi ose siç e quan edhe ndryshe autori dheu i zi., etj.. Gjithashtu jepen *dhe* veçoritë e tyre e përse ata përdoren, etj.

Në biosferë ose siç përmendet në tekst“ Jeta mbi Tokë”, krahas bimësisë e botës shtazore, trajtohet edhe njeriu. Në këtë pjesë tregohet ç’quhet florë (*për të shkruhet: “ të gjitha bimët e njëj krahine zbashku quhen flora e saj²⁸”*) dhe tërhiqet vëmendja në rolin që luan ngrohtësia dhe lagështira në jetën dhe zhvillimin e bimësisë në botë. Analizohet se sipas ndryshimit të tyre ndryshon dhe lloji i bimësisë në botë nga ajo pyjore, në bimësinë barishtore (në stepat e livadhet) dhe në bimësinë e shkretëtirës. Trajtohet gjithashtu bimësia e kultivuar dhe rëndësia që ka ajo. Si bimësia trajtohet dhe bota shtazore. *Për njeriun shkruhet: “ndër të gjithë qënset e kësaj bote njeriu asht ma i zhdrivilluemi, ma i nalti, i vetmi qënës qi din me folë, prandej asht zotnija i kësaj bote²⁹”*. ... Mandej analizohen kushtet sociale, ekonomike e kulturore të tij (bëhet fjalë për popullsinë në botë, besimet fetare, racat, ndryshimet kulturore, veprimtaritë ekonomike të njeriut, etj.).

Në fund të pjesës së dytë, jepen shkurtimisht të dhëna nga gjeografia regjionale dhe ajo e shteteve.

Një ndihmesë shumë të madhe në mësimin e gjeografisë në shkollë ka dhënë teksti i *Prof. A. Gashit me titull “ Gjeografia e Përgjithshme”për rendin e parë të shkollave Qytetse dhe të Mesme, botuar më 1935*. Në këtë tekst përveç dukurive të paraqitura në tekstet e mëparshme, trajtohen dukuri të reja e jepen të dhëna më të plota, që i përgjigjen nivelit të kohës. Është teksti më i pasur dhe më i plotë i botuar deri atëherë në vendin tonë me të dhëna e njohuri gjeografike nga të gjitha fushat e gjeografisë së përgjithshme. Teksti përbëhet nga katër pjesë:

Në pjesën e parë trajtohen dukuri, që u përkasin bazave astronomike të gjeografisë. Këtu analizohen e jepen njohuri të shumta për formën dhe

²⁸ *Po aty*, f. 46.

²⁹ *Po aty*, f. 46.

përmasat e Tokës si planet, polet, ekuatorin, paralelet, tropikët, meridianët, gjerësinë e gjatësinë gjeografike, e përcaktimi i tyre, etj. (në tekst shkruhet: “Largësia që ka një vënd prej ekuatorit, quhet Gjanësi Gjeografike³⁰. ... Largësia e një vëndi prej mesditësit të parë (meridianit zero V. K) quhet Gjatësi Gjeografike³¹. ...). Mandej trajtohen yjet e sistemi diellor (Dielli, Toka e planetët e tjerë, Hëna, etj.). Këta analizohet në të gjitha aspektet (ndërtimi i brendshëm, përmasat, lëvizjet, lidhjet midis tyre, etj.). Me shumë hollësi këtu trajtohet rrotullimi ditë e vjetor i Tokës e pasojat gjeografike të tyre, etj. . (në tekst shkruhet: “Dheu rrotullohet rreth boshtit të vet një herë në 24 orë, prej perëndimit në lindje. Nga ky rrotullim bahet nata edhe dita³². ... Dheu rrotullohet rreth Diellit një herë në një mot. ... Boshti Dheak ban me sheshin e rrugës së Dheut (planin e orbitës - V.K.) një kand prej 66 ½. ... Boshti i Dheut, kur ky i vjen rrotull Diellit, asht gjithënjë paralel me vehten e vet³³. ...). Po në këtë pjesë jepen të dhëna e njohuri për horizontin, mënyrat e orientimit, hartat, projeksionet, shkallën e zvogëlimit, paraqitjen e relievit në harta, profilin topografik, globet, etj. dhe rëndësinë që kanë këto në mësimin e gjeografisë.

Në pjesën e dytë trajtohen dukuri, që sot i takojnë gjeografisë fizike të përgjithshme . Në fillim të kësaj pjese jepen njohuri për konceptet e nocionet fiziko-gjeografike si ç’quhet oqean, det, gji detar, kontinent, ishull, gadishull, fushë, mal, vargmalor, pllajë, etj. (p. sh. për to shkruhet “Varg malesh ose varg quhen malet, që shkojnë e vargohen njani mbas tjetrit me një gjatësi të madhe³⁴. ... pllajë quhet një fushë e ngritun nalt përmbi vëndet që i gjinden përqark³⁵”). Mandej analizohen tiparet e kontinenteve dhe oqeanëve si dhe përshkruhen malet, fushat, pllajat, etj, në secilin kontinent dhe detet e gjiret më kryesore për secilin oqean, ishujt e arkipelagët ishullore, etj.

Mbas këtyre, nxënësit marrin njohuri për komponentët përbërës të Tokës. (për hidrosferën, atmosferën, etj.).

Gjatë trajtimit të hidrosferës, në fillin analizohen veçoritë fizike e kimike të ujërave detare (temperatura, kripësia, densiteti, akujt, valët,

³⁰ Ahmet Gashi, *Gjeografia e Përgjithshme për shkollat e mesme*, Tiranë: 1935, f. 25.

³¹ *Po aty*, f. 28

³² *Po aty*, f. 39.

³³ *Po aty*, f. 40-41.

³⁴ *Po aty*, f. 75.

³⁵ *Po aty*, f. 77.

rrymat, baticat e zbaticat, etj.) dhe faktorët që ndikojnë në ta (në tekst shkruhet: “ Densiteti i ujit ndryshon simbas temperaturës e simbash shkallës (sasisë - V.K.) të kripësisë. Detnat e brezave mesatare janë pak të kripur në sipërfaqe (e kanë kripësinë të vogël - V.K.) sepse reshjet atmosferike, që bien në ta janë të bollëshme dhe se derdhen shumë lumenj³⁶. ...). Kështu veprohet dhe për ujërat kontinentale: trajtohen elementët morfologjikë (burimi, grykëderdhja, vija ujëndarëse, sistemi lumor, etj.), dhe veçoritë hidrologjike të lumenjve (në tekst shkruhet: “burimi i një rrjedhjeje asht vëndi, ku fillon me ecë uji³⁷”. ...). Trajtohen liqenet e bëhet klasifikimi i tyre me ujë të ëmbël e të kripur, moçalet, burimet, etj.

Gjatë trajtimit të atmosferës, jepet definicioni ç’është atmosfera (për të shkruhet: “ atmosferë quhet shtresa e ajrit që e mbështjellë Dheun qark e për qark. ³⁸” ...). Mandej analizohen me hollësi të gjithë elementët klimatikë. Fillohet me erën dhe përshkruhen me radhë elementët e saj (forca e drejtimit), erërat e qarkullimit të përgjithshëm, musonet dhe erërat lokale (fëni, shiroku, bora), etj. . Në vazhdim trajtohet temperatura, ku veç nocionit ç’quhet temperaturë (për të shkruhet: “ Temperatura e një vëndi quhet numri i shkallëve të ngohtësisë së ati vëndi që na dëfton termometri³⁹”), analizohen me radhë temperatura ditore, mujore e vjetore e si ato gjenden, izotermat, etj. Mbas temperaturës analizohen me radhë lagështira e ajrit dhe reshjet atmosferike, si maten ato dhe si janë shpërndarë në rruzullin tokësor. Në fund trajtohet klima, si ç’quhet klimë (për të shkruhet: “Klimë quhet gjindja mesatare e motit mbas përfundimevet të marrun, në vërejtjet (vrojtimet) e bame shumë vjet me radhë⁴⁰”), bëhet klasifikimi i klimave në klimë detare e kontinentale dhe në vija të përgjithshme jepen tiparet e klimës në botë sipas zonave klimatike. . Gjatë trajtimit dhe përshkrimit të elementëve klimatikë dhe të klimës, analizohen shkaqet dhe faktorët, që ndikojnë në ta dhe rolin që ata lozin në rruzullin tokësor.

Në fund të kësaj pjese trajtohet ndryshimi i sipërfaqes së Tokës dhe krijimi i formave të ndryshme të relievit si pasojë e veprimtarisë së

³⁶ Po aty, f. 90.

³⁷ Po aty, f. 92.

³⁸ A. Gashi, *Gjeografia e Përgjithshme* ..., f. 104.

³⁹ Po aty, f. 110.

⁴⁰ Po aty, f. 114.

vullkaneve, tërmeteve, ujërave të shiut, ujërave rjedhëse, valëve detare, erës dhe veprimtarisë së njeriut.

Në tekst nuk trajtohet biosfera (bota bimore e shtazore). Kjo ndoshta se prof. A. Gashi bënte pjesë në ata gjeografë, që nuk e konsideronin biosferën si objekt studimi të gjeografisë, ndoshta se nxënësit këto njohuri i merrnin në shkencat biologjike, ndoshta ai është mjaftuar që bimësinë dhe botën shtazore t'i shohë vetëm si pasuri natyrore.*

Nga fusha e gjeografisë politike trajtohen probleme, që lidhen me popullsinë në botë, racat njerëzore, besimet fetare, format e qeverisjes dhe për qytetet. Për popullsinë jepen të dhëna për numrin e popullsisë sipas kontinenteve, dendësinë, rritjen natyrore, migrimet duke përcaktuar shtetet nga emigrojnë (si Italia, Anglia, Austria, Rusia) dhe vendet që presin emigrantë (ShBA, Kanada, Argjentina, Australi, etj) dhe shpërndarjen e popullsisë, vendet ku është përqendruar më tepër popullsia (Belgjika, Holanda, lugina e Renit, Kina Jugore, Pensilvania, etj.), si dhe faktorët që ndikojnë (faktorët klimatikë, afërsia me detin, pasuritë minerare, etj.). Trajtohen racat njerëzore (e bardhë, verdhë, zezë dhe e kuqe), besimet fetare kryesore monoteiste (të krishterët, myslimanët, Judaistët) dhe ato politeiste (budistët dhe hindu) dhe si ato janë shpërndarë në botë, gjuhët, kombet, ç'është shteti, llojet e shteteve dhe mënyrat e qeverisjes. Kjo pjesë përfundon me trajtimin e qyteteve të mëdhenj, ku janë përqendruar e popullsinë që ata kanë (për Europën qyteti më i madh përmendet Londra me 8 milion banorë, në Azi-Osaka me 2,5 milion dhe në Amerikën e Veriut - Nju Jorku me 10 milion banorë).

Në pjesën e fundit të tekstit jepen të dhëna, që janë objekt i gjeografisë ekonomike të përgjithshme. Në fillim bëhet fjalë për pasuritë natyrore duke i klasifikuar ato në pasuri minerare (kush bën pjesë në lëndët djegëse, metalet dhe gurët e çmuar), në pasuri bimore (kush bën pjesë në drithërat, në perimet e patatet, në bimët industriale, në drufrutorët e rrushin, në beharnat, etj.), në pasuritë shtazore (gjedhët, bagëti e imët, kafshët bartëse, për qumësht, lesh, mëndafsh, peshqit). Për të gjitha këto pasuri përmenden përse përdoren, ku janë më të përhapura, çfarë kushtesh natyrore kërkojnë, etj. Po kështu jepen të dhëna për industrinë e prodhimet industriale (industria nxjerrëse, metalurgjike, e

* Shënim: Në tekst si pasuri përmenden pyjet koniferë, pyjet gjethorë dhe pyjet ekuatorialë.

tekstileve, ushqimore, etj.), tregtinë, transportin, etj. Gjithashtu jepen prodhimi botëror dhe shtetet e vendet që dallohen për këto pasuri e këto prodhime. P. sh. prodhimi botëror i grurit më 1929 ka qenë 119 milion ton, nga këto ShBA -24 milion ton e Rusia -20 milion ton, etj.

Krahas njohurive nga gjeografia e përgjithshme, nxënësit merrnin njohuri dhe nga gjeografia regjionale dhe ajo e shteteve. Të dhëna të shumta për këto jepen në tekstin “Gjeografi” të Dh. Kotit, në “Njoftime Gjeografijet III”, në “Atdheshkronja e Bota” për klasën e katërt të I. Anamalit, në “Gjeografi” për klasën V-të, të Emin Çomos dhe në “Gjeografia” pjesa III të Nd. Palucës. Mënyra e trajtimit, me pak ndryshime, është gati e njëjtë në të gjithë tekstet. Europa trajtohet më gjerë, ndërsa kontinentet e tjerë përshkruhen shkurtimisht. Gjatë studimit të Europës, përshkruhen me hollësi kushtet fiziko-gjeografike (detet që e lagin, ishujt e gadishujt, relievi, klima, lumenjtë e liqenet, bimësia, pasuritë natyrore, etj.). Mandej jepen të dhëna për popullsinë, gjuhët që fliten dhe shtetet. Shtetet e mëdhenj si Anglia, Franca, Gjermania, Italia, Rusia, etj., përshkruhen gjatë, të tjerët shkurt (trajtohen kushtet natyrore, popullsia, qytetet, pasuritë natyrore, degët e ekonomisë, etj.). Gjatë përshkrimit të Europës dhe shteteve të saj, jepen ato që janë më karakteristike dhe më origjinale. P. sh në “Gjeografine” e Dh. Kotit shkruhet: “Klima e Europës shtrihet në brezin mesatar dhe është më e mira dhe më e shëndetëshme në botë ... Europa është kontinenti me njerëz të ditur, të kulturuar, e vënd i zhvilluar në bujqësi, industri, transport, etj.⁴¹” ..., kurse në “Gjeografia” pjesa III të Nd. Palucës shkruhet: “Tregtia e Britanisë përfshinë botën mbarë dhe asht në vështrim të plotë të fjalës tregti e përbotëshme⁴². ... dhe në tekstin e I. Anamalit “Atdheu e bota” për klasën e katërt shkruhet: “Gadishulli i Skandinavisë asht vënd malesh e akujsh, liqejsh e pyjesh. ... Në bregdetin janë sajue gjina shum të bukura, qi quhen Fiorde⁴³. “... Në të njëjtën mënyrë trajtohen edhe pjesët e tjera dhe shtetet që bëjnë pjesë në to. Trajtimi në këtë mënyrë i materialit e bënte më tërheqës mësimin dhe kuptohesh më lehtë nga nxënësit.

Një vend të veçantë në mësimin e gjeografisë në të gjitha ciklet e shkollave zinte gjeografia e Shqipërisë. Më gjerësisht për shkollat fillore

⁴¹ Dh. Koti, *Gjeografi per shkollat fillore ...*, f. 19-20.

⁴² Nd. Paluca, *Gjeografia për shkollat e mesme ...*, I, f. 51.

⁴³ I. Anamali, *Atdheu e bota ...*, f. 30.

gjeografia e vendit tonë trajtohet në “Gjeografia” e Dh. Kotit, në “Njoftime gjeografijet” II, në të dy tekstet “Atdheu e bota” të Ismail Anamalit dhe në gjeografinë e Sadi Pejanit, kurse për shkollat e mesme në “Dheshkrojen” e G. Mikelit dhe në tekstin e Prof. A. Gashit, i cili botoi një tekst të veçantë për gjeografinë e vëndit tonë më 1933 të titulluar “Gjeografija e Shqipnis” (ribotuar më 1937).

Gjeografia e Shqipërisë zinte një vend të rëndësishëm në arsimimin gjeografik të nxënësve. Si edhe në tekstet e botuar para vitit 1912, në të gjithë këto tekste, synohet të jepen sa më tepër njohuri për gjeografinë e vendit tonë, si për kushtet natyrore ashtu dhe ato ekonomiko-shoqërore (sigurisht duke iu përshtatur moshës së nxënësve dhe klasave ku zhvillohesh lënda). Gjithashtu dhe mënyra e paraqitjes së materialit është gati e njëjtë. Më hollësisht e më gjerë trajtohen brigjet detare (përmenden gjiret e kepet e detit Adriatik e Jon., dhe për disa jepen e veçoritë e tyre), malet, fushat, lumenjtë dhe liqenet. Në lumenjtë trajtohen të gjithë lumenjtë e mëdhenj (Buna, Drini, Mati, Erzeni, Semani e Vjosa), nga burojnë, ku derdhen, ku kalojnë e çfarë degësh marrin, si dhe pasojat që sjellin ujërat e tyre, kur dalin jashtë shtratit. Në liqenet, veç liqenit të Shkodrës, Ohrit e Prespës, përmenden lagunat e Karavastasë, Nartës, Butrintit, kënetat e Maliqit, etj. Në disa prej këtyre teksteve jepen edhe karakteristikat e tyre. *Kështu në “Gjeografinë” e Dh. Kotit për liqenin e Ohrit shkruhet: “... ka ujën të kulluar fare, nxierr një peshk të mirë që i thonë Koran, lekna dhe belushka⁴⁴”.* ...

Në tekstin e G. Mikelit, Dh. Kotit, “Njoftime gjeografijet” II, dhe në veçanti të A. Gashit, analizohen dhe veçoritë e klimës e faktorët që ndikojnë, madje dhe pasojat. *Kështu në “Atdheu e bota” të I. Anamalit për klasën e katërt shkruhet: “Shqipëria përgjithësisht klimën e ka të butë, d. m. th., as nuk ka të nxehtë të madh, as të ftohtë të tepërtë, pse gjindet në zonën e butë⁴⁵”.* ... kurse për pasojat në “Gjeografia e Shqipnis” të A. Gashit midis të tjerave shkruhet: “... Nganjihërë ndodhin edhe çudina, sikurse në dimnin e 1923-1924, kur ngrini edhe kënetat e Nartës. Po këtë vit u thanë 90% të portokajve edhe limojvet të Elbasanit e të viseve të tjera⁴⁶”. ... Në tekstin e G. Mikelit dhe atë të A. Gashit bëhet

⁴⁴ Dh. Koti, *Gjeografi për shkollat fillore* ..., f. 24.

⁴⁵ I. Anamali, *Atdheu e Bota* ..., f. 6.

⁴⁶ A. Gashi, *Gjeografia e Përgjithshme* ..., f. 38-39.

dhe rajonizimi klimatik duke dalluar klimën mesdhetare detare dhe mesdhetare kontinentale.

Në “Gjeografinë” e Dh. Kotit jepet dhe ndarja gjeografike e Shqipërisë në dy pjesë të mëdha: në Gegëri ose Shqipëri e Veriut, e cila përbëhet nga 21 krahina (Malësi e Dibrës, Luma, Malësi e Gjakovës, Hoti, Gruda, Shala, etj.) dhe në Toskëri ose Shqipëri e Jugut, që përbëhet nga 18 krahina (Çamëria, Labëria, Dangëllia, Kolonja, Devolli, Skrapari, Myzeqeja, etj.). Kufiri midis tyre është lumi Shkumbin.

Në kushtet natyrore malet dhe fushat zënë vendin më të gjerë. Në “Dheshkrojen” e G. Mikelit, në “Njoftime gjeografijet” II, dhe në “Atdheu e bota” për klasën e 4 të I. Anamalit, malet grupohen në katër vargje, kurse në “Gjeografia e Shqipnis” të A. Gashit në pesë vargje. Këto rajonizime, pjesërisht përputhen me rajonizimin e sotëm.

Gjatë trajtimit të maleve jepen gjithashtu vlerat e tyre e pasuritë, që ato posedojnë dhe përse ato përdoren. *Kështu në “Gjeografinë” e Dh. Kotit shkruhet: “ malet e Shqipërisë janë veshur me dru dhe me bimë. ... Ato me drurët e gjelbërinë e tyre, na japin shumë qereste dhe ushqim për bagëtinë. Në për keto ndodhen dhe shumë kafshë të egëra për gja⁴⁷”.*

Si malet përshkruhen edhe fushat. Përmenden fushat kryesore (fusha e Myzeqesë, Shkodrës, Zadrimës, Korçës, etj.). Për to jepen veçoritë, gjendja dhe vlerat e tyre: *Kështu në tekstin “Njoftime gjeografijet” III (e ripunuar) për fushat shkruhet: ... “ vënde vënde ka fusha të gjana e të begatëshme, të cilat sado qi prej ujnash myten herë here, prap se prap napin prodhime shumë si fusha e Myzeqesë, e Zadrimës, e Korçës, etj. ...⁴⁸”.*

Pas pjesës fizike përshkruhen me hollësi popullsia, ndarja administrative, qytetet, gjendja ekonomike e vendit. Kështu gjatë përshkrimit të popullsisë jepet numri i popullsisë, që banon në Shqipëri e në botë dhe si është shpërndarja e saj në Shqipëri e në shtetet e ndryshme të botës, besimet fetare e numri i tyre sipas feve, etj. Për ndarjen administrative përshkruhen e analizohen të 10 prefekturat veç e veç, nën/prefekturat e komunat, që bëjnë pjesë në to si dhe të gjithë qytetet. Për qytetet jepet numri i popullsisë dhe veçoritë më karakteristike të tyre (jepen të dhëna për artizanatin, çfarë prodhon, shkollat që funksionojnë, etj.). Kështu për Shkodrën në “Gjeografinë” e Dh. Kotit shkruhet: *“Shkodra, m’i madhi i qyteteve të Shqipërisë, me ndërtesa të mira, i*

⁴⁷ Dh. Koti, *Gjeografi për shkollat filllore ...*, f. 29.

⁴⁸ *Njoftime gjeografijet ...*, II, f. 55.

*bukur dhe fort i motshmë. Ndodhet më anët të kënetës së tij, në krye të Bujanës ku çiket me Drinë. Del duhan i bukur fort dhe me famë. Punohet mëndafshi, armët, argjendi, me 25 mijë ndenjës*⁴⁹. Në “Gjeografia e Shqipnis” të A. Gashit, të dhënat janë edhe më të shumta. Në to jepen të dhëna edhe për historinë e qyteteve, objektet e kultit, muzetë, rrugët, punishtet e fabrikat, shkollat, tiparet e pazareve, mjeshtëritë për të cilat dallohen qyteti, njerëzit e shquar që kanë nxjerrë, ngjarjet që kanë ndodhur, tipet e shtëpive, etj.

Një vend të veçantë në tekstet e mësipërme zë trajtimi i ekonomisë. Në të gjithë këto tekste pasqyrohet gjendja reale e saj dhe e gjithë veprimtaria ekonomike e vendit. Si dhe në tekstet e botuar para vitit 1912 (para Pavarësisë) evidentohet se bujqësia dhe blegtoaria janë dy degët kryesore ose bazë të ekonomisë shqiptare. Pothuajse në të gjithë tekstet shkruhet se në Shqipëri nuk ka gati asnjë prodhim bujqësor që të mos bëhet, kjo për faktin se klima e vendit është e ndryshme dhe e mirë për bujqësi dhe se toka është e frytshme. *Duke përshkruar bujqësinë në tekstin “Njoftime Gjeografijet” III (i ripunuar më 1931) shkruhet: “Bujqësia në Shqypni asht sidomos në drithna, vneshta, ullishta, barishte e pemë*⁵⁰. Gjatë trajtimit të bujqësisë në tekstet përmenden e përshkruhen kulturat kryesore bujqësore, që mbillen (drithërat, vreshtat, ullinjët, agrumet, drufrutorët, orizi, fasulet, etj.), rajonet ose zonat ku ato kultivohen më tepër (jepet përhapja gjeografike e tyre), cilët rajone dallohen për kultivim e prodhim (për kultivimin e prodhimin e drithërave, ullirit, vreshtave, agrumeve, duhanit, etj) dhe të çfarë cilësie ato janë (p. sh. duhani, ulliri, etj). Kështu për drithërat (misrin e grurin) në tekste përmenden fusha e Myzeqesë, e Zadrimës dhe e Korçës, për rritjen e ullinjve - kodrat e Vlorës, Mallakastrës, Elbasanit, Beratit, Shijakut, etj., për rritjen e rrushit – krahina e Shkodrës, Leskovikut, Pogradecit, Vlorës, etj., kurse për portokaj e limoj Vlora e Elbasani, etj. Në krahinën e Shkodrës e të Elbasanit bëhet duhan i mirë, që pëlqehet dhe në tregjet e huaj. Ndërsa për pemët përmenden se këto rriten në të gjithë Shqipërinë e ka shumë lloje si dardha, qershia, pjeshka, fiq, arra, kumbulla, molla, etj. Në këto tekste shprehet keqardhje se megjithëse bujqësia është pasuria më e madhe e Shqipërisë dhe se toka shqiptare nxjerr prodhime bujqësore të mira, ajo është e prapambetur dhe bëhet

⁴⁹ Dh. Koti, *Gjeografi per shkollat filllore ...*, f. 24-25.

⁵⁰ *Njoftime gjeografijet ...*, II, f. 55.

sipas mënyrës së vjetër. Si bujqësia trajtohet dhe blegtoria (rritja e dhenve, dhive, gjedhëve, etj., në cilat krahina ato rriten më tepër, prodhimet blegtorale që merren, etj.).

Në industri trajtohen dhe përmenden punishtet dhe fabrikat që ekzistonin në këtë periudhë (përmenden çfarë fabrikash janë ngritur, e çfarë prodhojnë, ku janë ngritur e si është gjendja e tyre). Kështu p. sh. përmenden fabrikat e duhanit në Shkodër, Durrës, Elbasan, etj., të sapunit në Shkodër e Elbasan, të vajit në Vlorë, Elbasan, etj., të miellit në Korçë, Vlorë, Tiranë, etj. Po kështu përmenden fabrikat e makaronave, alkoolit, shtypshkronja, etj., fabrika e çimentos në Shkodër, etj. Përmenden punishte të ndryshme dhe prodhime të artizanatit, cilët qytete dallohen, etj. Si industria trajtohen dhe pasuritë natyrore, tregtia e brendshme dhe e jashtme, produktet që shiten brenda e jashtë vendit, produktet që importohen, etj., transporti ku përmendet gjendja e pakët e rrugëve dhe që pengon zhvillimin, marrëdhëniet me botën, etj. Në mënyrë më të gjerë e më të plotë gjendja ekonomike dhe zhvillimi i degëve të ndryshme të ekonomisë, trajtohen në “Gjeografia e Shqipërisë” të A. Gashit. Në të jepen të dhëna dhe për sipërfaqet e mbjella me kultura të ndryshme bujqësore, për numrin e rrënjëve të drufrutorëve, për prodhimet vjetore bujqësore, blegtorale, industriale e artizanale, për tregtinë, etj., në rang mbretërie dhe sipas prefekturave, si dhe për të ardhurat që fiton shteti nga degët e ekonomisë, etj. P.sh. në vitin 1932 sipërfaqja e mbjellë me misër ishte 77, 9 mijë ha, dhe prodhimi 89 mijë ton, numri i dhenve 1, 5 milion dhe i dhive 975 mijë krerë, vlera e eksportit 4, 5 milion franga.

Nga analiza e shkurtër që u bëmë teksteve të mësipërm vëmë re se gjeografia e Shqipërisë është trajtuar gjerësisht dhe në të gjitha aspektet e saj, natyrore, ekonomike, politike, etj., dhe njohuritë e mara nga nxënësit kanë qenë të shumta. Si edhe në tekstet e botuar para shpalljes së Pavarësisë së vendit, është synuar që gjeografia e Shqipërisë të njihet sa më mirë dhe të ngjallet tek nxënësit ndjenja e patriotizmit dhe e dashurisë për vendin e popullin tonë, si dhe shprehet keqardhja e copëtimit të vendit tonë nga shtetet fqinjë. Tekstet e lartpërmendur kanë luajtur rol të madh në njohjen e gjeografisë së vendit tonë dhe në edukimin patriotik të nxënësve. Gjithashtu gjatë trajtimit të natyrës shqiptare në të gjithë tekstet bëhen përpjekje për të dhënë atë që është më e bukur, më e mirë dhe më karakteristike. Gjithashtu gjendja ekonomike trajtohet në tërë kompleksitetin e saj dhe dalin qartë, cilat kanë qenë degët bazë të ekonomisë, cilat kanë qenë kulturat bujqësore më të përhapura, cilat kanë

qenë prodhimet e industrisë dhe artizanatit e cilët qytete dalloheshin në këtë drejtim, etj.

Të gjithë autorët shkruajnë me patos, admirim e ndjenjë patriotizmi dhe me një dashuri të madhe për vendin tonë, për bukuritë e pasuritë natyrore të tij, për qytetet, popullsinë, për mençurinë e aftësitë e popullit shqiptar, etj. Kështu prof. A. Gashi duke shkruar për vargun malor lindor shprehet: *“këto male janë të veshuna me pyje dushku, ahue dhe pishë; sidomos në Gjalicën e Lumës brezi pylluer shkon deri mbi 2100m naltësi. Këto përmbajnë edhe kullota të gjana fort, ku janë ngrëfun stanet verore të blegtorëve të Lumës e të Dibrës⁵¹”*. ... kurse në tekstin “Gjeografia” të Dh. Kotit thuhet: *“Korça qytet i ri, me tregëti dhe mjeshtëri të madhe; m’i bukuritë dhe m’i shëndetshmitë qytet i gjithë Shqipërisë” ... dhe më tej vazhdon “Një gjë është vënë re në Shqipëtarët. Çdo punë që ta shikojë e bën, i vjen ndoresh dhe është një mjeshtër i mirë⁵²”*

Duke bërë një vlerësim të përgjithshëm të teksteve të botuar në periudhën 1912-1939, konstatojmë se në tekstet e mësipërm janë dhënë një gamë e gjerë njohurish gjeografike nga të gjitha fushat e gjeografisë dhe me të dhënat më të reja të kohës. Si dhe në tekstet e botuar para vitit 1912, janë dhënë ato njohuri e dukuri gjeografike që janë më të nevojshme, më të rëndësishme, që u përshtaten klasave ku zhvillohen e moshës së nxënësve dhe që ndihmonin në formimin gjeografik të tyre (nxënësve) për botën dhe vendin tonë. Tekstet në fjalë dallohen dhe për analizë shkencore, për nivel të lartë shkencor e saktësi shkencore. Me botimin e teksteve të prof. A. Gashit ka një rritje të ndjeshme të cilësisë në mësimin e gjeografisë në shkollë si për atë të përgjithshme e atë të Shqipërisë dhe se periudha mbas vitit 1930 mund të konsiderohet si periudha e konsolidimit të gjeografisë shkollore. Pikëpamjet për botën si dhe gjeografët para 1912, kanë qenë materialiste. Gjatë analizës së dukurive e objekteve gjeografike, nxirren shkaqet e faktorët që kanë vepruar e ndikuar. Dukuritë janë trajtuar në evolucionin e tyre duke nxjerrë në pah lidhjet dhe varësinë e ndërsjellë midis tyre, si dhe jepet përhapja gjeografike e tyre. Kjo mënyrë e trajtimit të dukurive gjeografike ishte në përputhje të plotë me trajtimin e dukurive gjeografike në Europë gjatë kësaj periudhe, ku gjeografia kishte bërë një hop të madh cilësor.

⁵¹ A. Gashi, *Gjeografia e Përgjithshme ...*, f. 23.

⁵² Dh. Koti, *Gjeografi per shkollat fillore ...*, f. 30.

Si personalitete të shquar të arsimit shqiptar dhe mësimdhënës me përvojë të madhe, të gjithë autorët kanë hartuar tekste me nivel të lartë dhe metodik. Për të gjitha sa përmendëm, mund të arrijmë në përfundim se gjeografisë në shkollë gjatë kësaj periudhe, i është dhënë po ajo rëndësi, që i kushtonin Rilindësit, të cilët e radhitnin gjeografinë së bashku me gjuhën, aritmetikën dhe historinë. Niveli i njohurive gjeografike si nga ana shkencore e metodike, që merrnin nxënësit në shkollë ka qenë i lartë dhe mund të krahasohet me nivelin e shkollave europiane. Hartimi i këtyre teksteve përbën gjithashtu dhe një kontribut të mirë në zhvillimin e gjeografisë në vendin tonë, e në veçanti të gjeografisë shkollore dhe në mendimin gjeografik shqiptar.

S u m m a r y

GEOGRAPHICAL PUBLICATIONS AND GEOGRAPHY TEACHING DURING THE PERIOD 1912-1939

In school books used during 1912-1939 we see that the geography of Albania is treated in all dimensions such as natural, economic, political etc. Thus, important knowledge was gained by the students in this topic. Starting from the texts written during the period of the proclamation of independence, the main objective was to plant the feelings of patriotism and the love for the country. Also, in the texts appear the concern for the territories snatched by neighboring countries. In these lessons, the strive is to show the beauty and the characteristic parts of the country. The economical situation in its whole shows the main branches of the economy, cultures of farming and the most known cities which apply them.

During the analysis of geographical objects and occurrences found in these school books, the purposes and causes were evidenced. The occurrences appear to be treated in the context of their evolution showing the relation between them, also by giving their geographical spreading. The methods used were the same as those used in Europe during that period.

Teachers and great personalities of Albanian education have composed high level scientifically and methodological texts. Thus, in the schools during 1912-1939 period the lesson of geography appears to be important such as others.

like language, arithmetic and history. The level of geographical lessons during the period of the consolidation of Albanian state, has been in the level of other European countries. The composition of such texts, also is a real contribution in the progress of Albanian geographical thought.